

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	SP-02
Nr. i Fajëve Br. Stranica No. Pages	-04-
Nr. i Prot. Braj Prot. Prot. No.	4765-2/25
Data: Datum: Date:	28.10.25
PRISHTINË / A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	15.10.2025
REFERENC-Ë:	25/4765/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Elektroheta" Sh.p.k. Ferizaj, Centrali Fotovoltaik 3MW në Varosh, Ferizaj
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/ a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit "Elektroheta" Sh.p.k. Ferizaj, për vceprimtarinë: Centrali Fotovoltaik 3MW në Varosh, Ferizaj.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, vizitës në teren, një sërë takimesh dhe mbajtjen e debatit publik me qytetar, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/4765/MMPHI
Datë: 15.10.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M


Aprovohet kërkesa me Nr.Prot.25/4765/MMPHI, e operatorit “Elektroheta” Sh.p.k. Ferizaj, për t’u pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Centrali Fotovoltaik 3MW në në ngastrën kadastrale ,P -72217011-01822-0,zona kadastrale Varosh, Ferizaj

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Të mirëmbahen shtresat antirefleksive në modulet solare, ku janë të vendosura qelqet ballore speciale për të ndaluar reflektimin e dritës;
- Të mirëmbahen pajisjet kundër zjarrit;
- Për sistemin menaxhues të mjedisit të ketë personin përgjegjës të profilit mjedisor;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe aktivitetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; <https://mmphi.rks-gov.net/>



- Të respektohet Direktiva për ruajtjen e zogjëve të egër, Direktiva 2009/147/EC

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot.25/4765/MMPHI, e operatorit "Elektroheta" Sh.p.k. Ferizaj, për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Centrali Fotovoltaik 3MW në në ngastrën kadastrale, P -72217011-01822-0, zona kadastrale Varosh, Ferizaj, MMPHI konstaton se operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 811049354, datë: 05.03.2014, e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Vendim për Pëlqim Mjedisor me Nr.:24/712/ZSP/ /24, të lëshuar me datë: 14.05.2024, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Certifikatë Përdorimi, nr.04-351/01-0028747/25, datë: 02.06.2025 lëshuar nga Komuna e Ferizajt;
- Pëlqim elektroenergjetik nga KEDS, Nr.8301, dt.23.08.2023

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore, ka realizuar vizitë në terren për verifikimin e kushteve mjedisore me dt. 30.07.2025, ndërsa organizimi i mbajtjes së debatit publik me qytetar me dt.09.09.2025

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, dhe nenin 13, të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, merrë vendim që operatorit të lardekur t'i lëshohet Leja Mjedisore.



Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Ferizaj;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së